


UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" PRISHTINË  
FAKULTETI EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT



Punim Masteri

**TEMA:**

Dallimet ndërmjet nxënësve nga Deçani dhe Podujeva në hapësirën antropometrike, motorikes bazike dhe të motorikes situacionale në lojën e hendbollit

**Mentori:**

Dr. Afrim Koca

**Kandidatët :**

Qamil Selmani & Atdhe Dacaj

Prishtinë, 2018

PËRMBAJTJA.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1. HYRJE .....	4
1.1. hulumtimet e deritanishme .....	5
2. QËLLIMI I HULUMTIMIT .....	9
2.1. Hipotezat e hulumtimit.....	10
3. METODAT E HULUMTIMIT .....	11
3.1. Mënyra e zbatimit të hulumtimit .....	11
3.1.1 Variablat antropometrike matëse .....	12
3.1.2. Variablat e motorikes bazike dhe motorikes situacionale.....	12
3.2. Instrumentet matëse dhe teknika e tyre .....	14
3.2.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike .....	15
3.2.2. Përshkrimi i instrumenteve matëse të motorikes bazike .....	19
3.2.3. Përshkrimi i instrumenteve matëse të motorikes situacionale.....	23
3.4. Metodatat e përpunimit të rezultateve .....	25
4. REZULTATET DHE DISKUTIMET .....	26
4.1. Parametrat themelorë statistikorë të matjeve antropometrike në Deçan dhe Podujevë .....	26
4.1.1 Rezultatet e parametrave themelorë statistikorë të matjeve antropometrike në Deçan .....	26
4.1.2 Rezultatet e parametrave themelorë statistikorë të matjeve motorike bazike dhe situacionale në Deçan .....	27
4.1.3 Rezultatet e parametrave themelorë statistikorë të matjeve antropometrike në Podujevë .....	28
4.1.4 Rezultatet e parametrave themelorë statistikorë të matjeve motorike bazike dhe situacionale në Podujevë .....	29
4.2. Korrelacionet e rezultateve të nxënësve nga Deçani dhe Podujeva .....	30

4.2.1 Koeficientet e korrelacioneve në hapësiren antropometrike Deçan .....	30
4.2.2 Koeficientet e korrelacioneve të variablave, motorike bazike dhe situacionale të Deçanit .....	31
4.2.3 Koeficientet e korrelacioneve në hapësiren antropometrike në Podujevë...	32
4.2.4 Koeficientet e korrelacioneve të variablave, motorike bazike dhe situacionale në Podujevë .....	33
4.3 Kroskorelacionet ne mes të variablave antropometrike dhe motorike.....	34
4.3.1 Kroskorrelacionet ndërmje variablave antropometrike dhe motorike në hapësiren manifeste të nxënësve nga Deçani .....	34
4.3.2 Kroskorrelacionet ndërmje variablave antropometrike dhe motorike në hapësiren manifeste të nxënësve nga Podujeva .....	35
4.4 T-Testi ndërmjet grupit të nxënësve nga Deçani dhe nxënësve nga Podujeva në hapësiren antropometrike dhe motorike .....	36
5. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6. PËRFUNDIMI .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b> 9
7. BIBLIOGRAFIA .....	41
8. Paraqitja grafike e rezultateve antropometrike dhe motorike ndërmjet grupit të nxënësve nga Deçani dhe Podujeva .....	43

## 1.HYRJE

Loja e hendbollit me format e saja situacionale të lëvizjeve, kërcime atraktive, që ekzekutohen në fazën e sulmit dhe të mbrojtjes, gjithnjë e më shumë po hyn në analet e sporteve më të popullarizuara në botë. Me lëvizje dhe vrapime të shpejta, kërcime eksplozive, kontakte te ndryshme me kundërshtarë, bënë që topi i hendbollit ti argëtojë miliona adhurues në mbarë botën. Hendbolli si lojë sportive kolektive, vazhdimisht, përsoset dhe zhvillohet, në të gjitha nivelet e tija, në organizim të përsosur, dhe ngritje të cilësisë së punës dhe përkushtim me gjenerata të reja.

Përmes lojës së hendbollit arrihet transformimi i karakteristikave antropometrike, fiziologjike, motorike, kognitive, konative dhe motorike situacionale (Zeqa, V. 2004; Selimi, M. 2001). Është lojë me numër të pakufizuar të lëvizjeve duke filluar prej atyre elementare deri te ato më komplekse të cilat ndërlidhen me aftësitë fizike, teknike dhe taktike të lojtarit. Avancimi dhe reformimi i metodave të punës në hendboll, ka bërë që kjo lojë në ditët e sotme të jetë shumë dinamike dhe atraktive.

Duke ditur rëndësinë që ka loja e hendbollit e cila zë vend të rëndësishëm në familjen e sporteve kolektive, këtu në Kosovë ku një përparim të dukshëm në drejtim të afirmimit dhe masivizimit të këtij sporti.

Një ndër elementet kyçe në lojën e hendbollit janë hapësira antropometrike e lojtarëve dhe përgatitja fizike e tyre. Për të vlerësuar zhvillimet e sportit të Hendbollit tek nxënësit në Komunën e Deçanit dhe në Komunën e Podujevës dhe për të vërtetuar dallimet ndërmjet tyre do të mundohemi që nëpërmjet këtij punimit ti vërtetojmë.

## 1.1 Hulumtimet e deritanishme

Në këtë hulumtim jemi bazuar duke i përdorur disa nga hulumtimet e e deritanishme të cilat janë bërë në vendin tonë dhe në shtetet e tjera të lëmisë së ngjashme e të cilat poashtu kanë të bëjnë më të njejtën problematikë hulumtuese si në hapësiren antropometrike poashtu edhe në atë të motorikes bazike dhe situacionale në lojën e hendbollit, si autorë nga vendi i kemi prezantuar në vazhdim:

**Çitaku., F.** (1981), në hulumtimin e tij të quajtura “ Struktura latente e precizitetit” të cilin e realizuar me nxënësit e shkollave të mesme të moshës 18 vjeçare në komunën e Lipjanit, të Pejës dhe të Podujevës. Për këtë hulumtim ka pasur gjithsej 32 ndryshore të precizitetit motorik, ndërsa numri i entiteteve ishte 496 nxënës. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë konstatimi i strukturës primare të precizitetit latent. Në këtë hulumtim është punuar me analizën faktoriale latente të strukturës së precizitetit, me ç’rast janë vërtetuar tre nivele të strukturës latente të precizitetit.

**Koca., A.** (2009), edhe autori në hulumtimin e tij në sportin e hendbollit me titull: “Relacionet dhe ndryshimet në hapësiren antropometrike, funksionale dhe aftësive levizore bazike e të levizjeve situacionale ndermjet hendbollistëve (juniorë) të superligës dhe ligës së parë të kampionatit të kosovës në hendboll” autori në këtë hulumtim ka arritur të vërtetoj relacionet në hapësiren manifeste dhe ka përdorur faktoriale dhe analizen e T-testit.

**Nixha., M.** (1985) Në disertacionin e e tij me titull “Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese dhe analiza komparative me volejbollistë dhe hendbollistë”, ku si mostër entitetesh ka marrë lojtarët të tri rangjeve, kurse mostra e ndryshoreve ka qenë 11 antropometri dhe 7 motorikë.

**Nixha., M.** (1982) Në një hulumti shkencorë me titull “ Analiza kooperative e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese”. Mostra e etniteteve kanë qenë tri ekipe të para të ligës së dytë të ish federatës së atëhershme dhe tri ekipet e para të ligës së parë të Kosovës në sezonin 1981 / 1982.

**Gabrijelic., M.** (1977), ky autor në mostrën etij prej 222 sportistëve kulminantë të rangut federativ, të moshës 18-25 vjeçare, anëtar të kategorisë së sporteve mashkullore, basketboll (54), futboll (52), volejboll (58), hendboll (58), lidhmëria e dimensioneve manifeste latente, të përgjithshme dhe situacionale motorike, kognitive dhe konative me sukses në secilën lojë sportive posaçërisht, atë e ka bërë analizën komparative të lojërave sportive. Janë përdorur 16 teste universale në të gjitha grupet e të testuarve , dhe atë nga tre teste situacionale situacionale për secilën lojë sportive . Aftësitë e basketbollistëve kulminant në krahasim me sportet tjera janë renditur si në vazhdim : Basketbollistët janë superior në forcën eksplozive të këmbëve dhe duarve, kurse më inferior në shpejtësinë e vrapimit. Përveç kësaj të gjitha dimensionet manifestuese të neurotizmit gjeneral të basketbollistëve janë më se paku të shprehura në raport me tri lojërat tjera sportive.

**Gjinolli., E.** (1997), në temën “ Karakteristikat antropometrike të vlefshme për volejboll të nxënësit e klasës së pestë të shkollës fillore “ (4) ka bërë hulumtimin duke pasur qëllim thelbësor antropometrinë dhe motoriken me nxënësit me orientim në volejboll. Në faktorizimin e hapësirës antropometrike janë izoluar dy dimensione latente antropometrike: në analizën regresive në mostrën e variablave predikore janë përfshirë 18 ndryshore antropometrike, kurse në atë motorike 10.

**Selimi., M.** (2001), në hulumtin e tij ka arritur të bëjë vlerësimin e parametrave antropometrik dhe motorik të hendbollistëve të Anamoravës,(7) me ç'rast ka përdorur analizën faktoriale dhe iu kanë ekstrahuar tre faktorë latent në hapësirën antropometrike dhe tre faktorë latentë motorik të cilët janë emërtuar si: 1.Faktori longitudinal dhe transversal i skeletit.

2.Faktori i dimensionit cirkular dhe i masës së trupit.

3.Faktori i dimensionit cirkular dhe transversal i gjymtyrë të poshtme.

Ndërsa në hapësirën motorike:

1.Faktori i fleksibilitetit dhe i aftësive të lëvizjeve situacionale me top.

2.Faktori i udhëheqjes së topit në gjysmërreth dhe agjilitetit.

3.Faktori i shpejtësisë së udhëheqjes së topit dhe i forcës eksplozive

**Rakovica, H.** (1998) poashtu ky autor në hulumtimin në hulumtin e tij të quajtur "Hapësira motorike e fëmijëve të moshës 11 vjeçare dhe faktorizimi i saj"<sup>11</sup>, në mostrën prej 300 nxënësve ka trajtuar aftësitë motorike të tyre përmes 14 testeve. Me analizën faktoriale ka ekstraktuar 4 faktorë latentë të hapësirës motorike:

1.Faktori i shpejtësisë dhe i forcës.

2.Faktori i forcës statike dhe përsëritëse i këmbëve.

3.Faktori i lëvizshmërisë së këmbëve.

4.Faktori forcës statike dhe përsëritëse të këmbës.

**Çitaku, F. (1981)** ky autorë ka bërë hulumtime në hapësirën motorike në segmente të forcës,shpejtësisë dhe precizitetit.Këto hulumtime i ka realizuar me 118 sportistë aktivë(hendbollistë,basketbollistë dhe volejbollistë) të ligës së Kosovës dhe asaj Federative.Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë përcaktimi i strukturës faktoriale të variablave të zbatuara,përcaktimi i ndërlidhjeve faktoriale në hapësirën

manifeste dhe latente, varësisht nga tri grupet e sportistëve. Në bazë të analizës së të dhënave janë emërtuar katër faktorë të rëndësishëm:

Faktori i parë është definuar si kombinim i forcës repetitive dhe statike ,

faktori i dytë është definuar si forcë eksplozive,

faktori i tretë është emërtuar si kombinim i forcës statike në radhë të parë dhe si forcë repetitive në rend të dytë. Është konstatuar se preciziteti nuk është ekstrahuar si faktor. Variablat e aplikuara të hapësirës baïke motorike nuk diferencojnë sportistët në grupe.

**Koca, A.** (2004) Gjatë punës së tij në punimin e magjistraturës nga testet e aplikuara dhe metodat e shfrytëzuara në hulumtimin e bërë ka qenë të vëhen në pah ndryshimet ndërmjet katër grupeve në të dy hapësirat si dhe të vërtetohen ndërlidhjet (relacionet) e dimensionëve antropometrike dhe motorike në mes të sportistëve të katër sporteve kolektive (hendbollisteve, basketbollistëve, hendbollisteve dhe volejbollistëve).



## 1. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Për të vlerësuar lojën e hendbollit tek nxënësit duhet hulumtuar në hapësirën antropometrike, motorike e sidomos në hapësirën e motorikes situacionale të lojës së hendbollit.

Si qëllim i parë në këtë punim master mund të jetë vlerësimi në hapësirën antropometrike për nxënësit të cilët jetojnë në dy vende të ndryshme gjeografike në Kosovë siç është Deçani dhe Podujeva dy vende të cilat gjenden në dy pjesë të ndryshme gjeografike në Kosovë, dhe mund të vërtetojmë dallimet në hapësirën antropometrike ndërmjet këtyre dy vendeve.

Si qëllim tjetër në këtë punim mund të identifikojmë relacionet ndërmjet matjeve antropometrike me testet e motorikes bazike dhe atyre situacionale në lojën e hendbollit se ku gjendet niveli i kësaj grupmoshe në aspektin morfologjik, motorik dhe atyre situacionale.

Gjithashtu si qëllim tjetër i këtij hulumtimi është që të mund të vërtetojmë dallimet ndërmjet nxënësve nga Deçani dhe Podujeva në aftësitë e motorikes bazike si dhe motorikes situacionale në lojën e hendbollit.

## 2.1 Hipotezat e hulumtimit

Hipotezat e këtij hulumtimi janë paraqitur në bazë të qëllimit të këtij punimi dhe ato janë :

H<sub>1</sub> – Supozoj se do të paraqiten dallimet në rezultatet nxënësve në hapësirën antropometrike ndërmjet Deçanit dhe Podujevës.

H<sub>2</sub> – Supozoj se do të paraqiten dallimet në rezultatet nxënësve në aftësitë e motorikes bazike ndërmjet Deçanit dhe Podujevës.

H<sub>3</sub> - Supozoj se do të paraqiten dallimet në rezultatet nxënësve në aftësitë e motorikes situacionale në lojën e hendbollit ndërmjet Deçanit dhe Podujevës

### 3. METODAT E HULUMTIMIT

#### 3.1 Mënyra e zbatimit të hulumtimit

Bazuar në qëllimin e këtij punimi dhe për të arritur të mbulojmë rrugën e realizimit të tij ne do të shërbehemi me metodat kryesore të cilat aplikohen në lëmin e hulumtimeve të kulturës fizike e këto janë: metoda deskriptive dhe ajo eksperimentale. Mostër në këtë hulumtim i kemi marrë nxënësit të shkollës së mesme të lartë nga dy qytete të ndryshme Deçani dhe Podujeva. Në këtë punim do të kemi si mostër për të eksperimentuar mbi 70 nxënës meshkuj nga Deçani dhe 70 nxënës meshkuj nga Podujeva të moshës 16 vjeçare  $\pm$  6 muaj, klasa e X.

Matjet antropometrike do të kryhen në mëngjes (Rexhepi, A. 2009) dhe matjet do ti bëjë grupi i studentëve të cilat kanë njohuri paraprake për teknikat e matjes.

Matjet në hapësirën e motorikes bazike dhe ato të motorikes situacionale do të kryhen në sallat e Edukatës Fizike nëpër shkollat ku këta nxënës mësojnë, edhe këto matje do të kryhen nga të njëjtit kolegë të cilët kanë përvojë në këtë fushë dhe me mjete adekuate për matje të motorikes bazike dhe asaj situacionale.

### 3.1.1 Variablat antropometrike matëse

Variablat për matjen e ndërtimit morfologjik janë marrë nga Sistemi Biologjik Ndërkombëtar (IBP), ndërsa variablat e motorikes bazike dhe testet e motorikes situacionale të standardizuara për lojën e hendbollit.

Në këtë punim në i kemi marrë për bazë 4- variabla antropometrike sepse ne si autore mendojmë që është e mjaftueshme për një hulumtim të tillë për të bërë një vlerësim në aspektin morfologjik të dimensioneve për të dy qytetet Deçan dhe Podujevë.

#### VARIABLATA ANTROPOMETRIKE

1. **APESHA** - Pesha e trupit
2. **ALARTE** - Lartësia e trupit
3. **AGJKRH** - Gjerësia e krahëve të hapur
4. **AGJASH** - Gjatësia e shuplakës së dorës

### 3.1.2. Variablat e motorikes bazike dhe motorikes situacionale

Edhe testet e motorikes bazike dhe motorikes situacionale janë analizuar nga autorë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë (Koca, A., 2009; Çitaku, F. 1981). Për këtë punim ne i kemi marrë këto teste të motorikes bazike:

#### TESTET E MOTORIKES BAZIKE:

1. **MVRA 40m** - Starti i lartë - Vrapimi në 40 metra
2. **MKGJVT** - Kërcim së gjati nga vendi.
3. **MHMED** – Hedhja e Medicinbollit
4. **MKLART** - Kërcim së larti nga vendi.

#### TESTET SITUACIONALE NË HENDBOLL:

1. **MUVRA** – Udhëheqje e topit me vrapim 40m
2. **MSPRE** - Gjuajtja në trehapësh në cak.
3. **MVZ6-9m** - Vrapim zik-zak në mes 6 dhe 9 metërshit.

### **3.2. Instrumentet matëse dhe teknika e tyre**

Matjet e këtij hulumti janë organizuar gjatë orëve të rregullta të shkollave përkatëse në fushën e sportit ku ata i mbajnë procesin mësimorë të rregullt. Përpara se të filloj procesi i matjes së nxënësvesecili nxënës ka qenë i njoftuar verbalisht me informatë për mënyrën e matjes dhe pozitat të cilat duhet të qëndrojnë ata gjatë procesit të matjes. Gjithashtu është treguar edhe qëllimi i këtyre matjeve, në mënyrë që mos të jenë të njoftuar paraprakisht nxënësit gjatë procesit matës dhe të ndihen sa më të lirë. Pjesa e matjeve të hapësires antropometrike është bërë në ambientet e brendshme të shkollës. Ndërsa matjet janë bërë me ndihmën e kolegëve të edukimit fizik dhe sportit të cilët paraprakisht kanë bërë përvojën e duhur për të realizuar këto matje.

Nxënësit gjatë realizimit të matjeve antropometrike kanë qenë të zbathur të veshur vetëm në veshje sportive, sipas programit internacional biologjik. Matja e parametrave antropometrikë është realizuar në orët e para të ditës edhe atë nga 8:00 deri në orën 12:00 në hapësirën e cila ka qenë mjaftë e ndriçuar. Mjetet e përdorura në këtë matje kanë qenë të bazhdaruara paraprakisht. Gjithashtu për të realizuar teste e motorikes bazike dhe asaj situacionale janë përdorur mjetet e standardizuara dhe të bazhdaruara paraprakisht, gjatë realizimit të testeve motorike nxënësit kanë qenë të përkushtuar maksimalisht dhe i kanë realizuar testet sipas udhëzimeve tona, në disa nga testet ato janë përsëritur nga disa herë në mënyrë që të mirret rezultati më i mirë.

Instrumentet për të realizuar matje antropometrike dhe ato të motorikes bazike dhe asaj situacionale janë si në vijim:

- peshorja, me saktësi të matjës prej 0,1 kg,
- kronometri digjital
- shiriti metrik dhe plastik
- konat plastik
- ngjitës i letrës
- Topat/ medicinboli 4kg,etj.

### 3.2.1.Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike

#### Pesha e trupit (APESHA)

Mjeti matës: Peshorja antropometrike

Pesha është matur me peshoren antropometrike, e cila mundëson saktësinë e matjes prej 0.1 kg, treguesi rregullohet në pozitën zero. E domosdoshme është që peshorja të vihet në pozitë horizontale dhe të ketë bazament të fortë nga poshtë saj. I testuari është i zbathur në veshje sportive me sa me pak rroba, qëndron i qetë, në këmbë, në mes të peshores. Pasi të qetësohet boshti (treguesi) i peshorës në pozitën ekuilibruese lexohet rezultati. Rezultati lexohet bëhet me saktësi 0.1 kg.



Foto 1

## Lartësia e trupit (ALARTE)

Mjeti matës: Antropometri sipas Martinit

Për të matur lartësinë e trupit kemi përdorur antropometrin sipas Martinit, nxënësi që është matur ka qenë i zbathur, në veshje sportive dhe të qëndrojnë në bazament të fortë horizontal. Koka e tij duhet të jetë në atë pozitë që skaji i poshtëm i syrit dhe skaji i epërm i zgavrës së jashtme të veshit të jenë në pozitë horizontale ose ndryshe njihet si (horizontalja e Frankfurtit). Qëndrimi i trupit të nxënësit ka qenë i relaksuar dhe i drejtë, shpatat e bashkuara, ndërkaq matësi qëndron në të majtë të tij. Pasi të kontrollohet pozita e nxënësit dhe të instrumentit (antropometrit), atëherë e lëshon krahun horizontal të antropometrit deri në pjesën parciale të kokës (pika më e lartë e kokës – vertex). Rezultati lexohet bëhet me saktësi 0.1cm.



Foto 2



### Gjatësia e krahëve hapur ( AGJKRH)

Gjatësia e krahëve hapur është matur me antropometër që është vendosur në sipërfaqe të rrafshët (në mur) në pozitë horizontale. Matja është bërë prej gishtit të mesëm(digitus medius) të dorës së majtë,deri te gishti i mesëm i dorës së djathtë. Saktësia e matjes 0.1cm




Foto 3

## Gjatësia e shuplakës së dorës (AGJASH)

Gjatësia e shuplakës së dorës matet me kompas rrëshqitës me krah më të gjatë, nxënësi qëndron me krahun e majtë të shtrirë mbi gjurin e majtë. Dora e majtë duhet në bërryl të jetë në fleksion  $90^{\circ}$  ( shkallë ) me pëllëmbë të kthyer në drejtim përpjetë , dhe me gishtërinj të shtrirë horizontalisht. Njëri krah i instrumentit vendoset në daktilin, ndërsa tjetri krah në interstilion (pika ndërmjet zgjatimit stiloid radial dhe ulnar), rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.



Foto 4

### 3.2.2 Përshkrimi i instrumenteve matëse të motorikes bazike

#### Starti i lartë – vrapimi në 40 metra (MVRA40m)

Mjetet: Kohë matës, (Kronometër), shiriti ngjitës, kona për shënimin e startit dhe cakut. Detyra: Nxënësi qëndron me të dy këmbët pas vijës së startit, në pozicionin starti i lartë. Matësi jep komandën “gati” pas së cilës subjekti përkulet para, me peshën në këmbën e përparme dhe “tani” pas së cilës nxënësi fillon vrapimin dhe maksimalisht shpejtë të vrapon në distancën 40 m. Në momentin kur startuesi jep komandën “tani”, duke lëshuar dorën prej pozitës horizontale – poshtë, matësi i kohës e nis matjen me kronometër dhe e ndalë atë kur subjekti e kalon me gjoks vijën e cakut.

Vlerësimi: koha matet prej startit deri te caku dhe rezultati i fituar shënohet në fletë testin përkatës me saktësi 0.10sec.




Foto 5

### Kërcim së gjati nga vendi - MKGJVT

Mjetet e punë: Tre dyshek gjimnastikorë të trashësisë 5-7 cm, pedana standarte, magnesium dhe metri metalik. Mënyra e ekzekutimit Një metër pra dyshekëve gjimnastikorë është e vendosur pedana e kthyer nga pjesa e përparme, ndërsa dysheket janë të mbështetur me njërin skaj në mur për të mos rrëshqitur. Procedurat: Nxënësi kërcen duke u shtyrë me të dy këmbët, nga pjesa e përparme e pedanës, dhe bie në dyshek sa më larg që mundet. Gjatë shtytjes lejohet hovi me krahë, por shtytja dhe rënia duhet të bëhet më dy këmbët. Regjistrohet distanca nga vija shtytëse deri te gjurma më e afërt në dyshek. Testi është përsëritur 3 herë dhe shënohet rezultati më i mirë. Rezultati shënohet me saktësi prej 0.1 cm.




Foto 6

### Hudhja e medicinbollit nga pozita e shtrirë - MHMED

Mjetet: Topi medicinball dhe metri. Mënyra e zbatimit : Gjatë matjes duhet të jenë dy matës, njëri duhet të qëndroj afër nxënësit, tjetri në cak e përcjell sakt ku po bien topi afër shiritit matës. Nxënësi vendoset me dy këmbë paralel dhe nga pozita e drejtë me krahët në drejtim të gjoksit duke e mbajtur topin e medicinbollit me peshë 4 kg. Krahët duhet të jenë të thyer në brryla në mënyrë që medicinbolli me gjysmën e tij të takoj gjoksin, metri vendoset nga vija e ku qëndron nxënësi në një largësi të paraparë deri 10m. Nxënësi e hedhë medicinbollin sa më larg që mundet, gjatë hedhjes trupi qëndron i drejtë, pa e lëvizur trupin. Nxënësi i ekzekuton tri tentime dhe shënon rezultatin më të mirë. Vlera shënohet me saktësi prej 0.1 cm.




Foto 7

## Kërcim së larti nga vendi - MKLART

Mjetet e punës: Shiriti metrik, një ndihmës. Mënyra e zbatimit: Nxënësi në fillim duhet të ofrohet afër murit, ku është i ngjitur shiriti milimetrik, pozicioni është në drejtqëndrimi kthyer anash murit, krahun afër me murin duhet ngritur lartë afër shiritit në majën ku prekë gishti më i gjatë i dorës shënohet vlera e lartësisë fillestare.

Ekzekutimi: Nxënësi duke u përkulur në poshtë dhe duke e shfrytëzuar hovin e krahëve shtyhet sa më lart dhe takon pikën më të lartë të mundshme në shiritin milimetrik. Vlera regjistrohet dhe nga kjo vlerë zbritet vlera e lartësisë fillestare.

Diferenca në mesë këtyre vlerave shënon vlerën e kërcimit nga vendi në lartësi.

Subjekti ekzekuton tri tentime dhe shënon rezultatin më të mirë. Vlera shënohet me saktësi prej 0.1 cm



Foto 8

### 3.2.3 Përshkrimi i variablave motorike situacionale

#### Udhëheqja e topit me vrapim 40m MUVRA

Vija e startit është te vija ku takohet vija e 6 metërshit me vijën fundore. Nxënësi në këtë rast ka për detyrë që nga vija e nisjes të vrapoj sa më shpejt që është e mundur duke udhëhequr me top kah vija tjetër e 6 metershit . Ky test përsëritet dy here pa ndërprerë pasi që këtu testohet: shpejtësia vepruese me top,niveli teknik i zbatimit të udhëheqjes dhe qëndrueshmëria situacionale. Në fillim lojtares i matet pulsi në qetësi dhe pas ngarkesës. Matet prej startit deri te caku dhe rezultati i fituar shënohet në fletë testin përkatës me saktësi 0.1sec.



Foto 8

### **Gjuajtja me trehapësh në cak – MSPRE**

I testuari vendoset larg 3 metra prej vijës së 9 metërshit i kthyer me fytyrë nga porta. Para vetes ka 5 topa dhe ai sugjerohet se duhet të gjuhen 5 gjuajtje duke e ekzekutuar trehapëshin dhe me kërcim të gjuaj në cak. Pasi ndihmësi i jep topin në dorë, i testuari është i obliguar që të bëj tre hapëshin dhe të gjuaj në cak, ku në këndin e djathtë të sipërm të portës është e vendosur një tablo me dimensione 1mx1m, i testuari ka për të gjuajtur në cak (tablo). Në fletëtestim shënohen vetëm goditjet e sakta në cak.



Foto 9

### **Vrapim zik - zak në mes 6 dhe 9 metërshit – MVZ6m9m**

Në vijën fundore e tërheqim një vijë 2m në drejtim të 9m, ku prehet kjo vijë tek 9 metërshi dhe e vendosim një kon të plastikës, të njëjtën gjë e bëjmë edhe në anën tjetër të fushës tek vija e 6 metërshit, brenda këtyre dy koneve të plastikës vendosim edhe dy të tjera me distancë të njëjtë njëra me tjetrën, përreth vijës së 6 metërshe dhe 9 metërshe. Nisja është te vija fundore në mes 6-9m në anën e majtë të fushës. Subjekti duhet të bëjë lëvizje zik-zake në mes konave nga vija e 6-9 në drejtim të nga e para deri te e fundit. Pas kalimit të kësaj distance subjekti bëhet matja e kohës dhe rezultati i fituar shënohet në fletë testin përkatës me saktësi 0.1sec



### 3.4. Metodatat e përpunimit të rezultateve

Në bazë të qëllimit të parashtruar është zgjedhur edhe metodologjia e përpunimit të rezultateve

Për të interpretuar rezultatet do të përdoret paketa matematikore SPSS versioni 23.0 për Windows.

Parametrat themelorë statistikorë:

- Mesi aritmetik,
- Devijimi standard,
- Gabimi i mesit aritmetik,
- Asimetria e distribucionit (Skeë)
- Shtrirja e distribucionit (Kurt)

Parametrat tjerë statistikorë (analizat):

- Korrelacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike bazike dhe motorikes situacionale.

Kroskorrelacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike bazike dhe motorikes situacionale.

Analizës T-test e cila na e mundëson të vërtetojmë dallimet ndërmjet nxënësve nga Deçani dhe atyre nga Podujeva.

## 4.REZULTATET DHE DISKUTIMET

### 4.1. Parametrat themelorë statistikorë të matjeve antropometrike në Deçan dhe Podujevë

#### 4.1.1. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të matjeve antropometrik në Deçan

Në tabelën 1 janë paraqitur parametrat themelor statistikorë të katër variablave antropometrike të 70 nxënësve nga komuna e Deçanit, e që mendohet se janë të mjaftueshme për të bërë një eksperiment të tillë. Nga rezultatet e fituara mund të vërehet se nga të gjitha variablat e të lartcekura kanë rezultuar me rezultate asimetrike nga ato minimale deri tek ajo maksimale, përveq variabla e peshës e cila treguar devijim më të lartë të rezultateve nga minimumi i cili është paraqitur me 46.90 kg dhe maksimumi me 108.00 kg ndërsa mesatarja aritmetike ka vlerën e 67.78 kg e cila ka një devijim të theksuar në vlerë prej 13.663. Me këto rezultate përveq dallimit në peshë me rezultatet e tjera nxënësit nga komuna e Deçanit kanë qenë përafërsisht të njëjtë dhe mund të themi se në hapësirën antropometrike grupi është mjaft homogjen dhe nuka kanë dallime njëri prej tjetrit.

**Tabela 1 Parametrat themelor statistikor të variablave antropometrike në Deçan.**

Variablat	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skeë.	Kurt.
APESHA	70	46,90	108,00	67,78	13,663	,922	,765
ALART	70	163,00	196,00	177,24	6,146	,242	,579
AGJKRH	70	160,00	193,00	177,02	6,626	,110	-,058
AGJASH	70	16,50	21,10	18,81	1,021	-,051	-,390

#### **4.1.2. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave, motorike bazike dhe situacionale në Deçan**

Në tabelën 2, gjithashtu janë paraqitur rezultatet e hapësires motorike bazike dhe të motorikes situacionale me variablat e përzgjedhura për këtë punim me nxënësit e komunës së Deçanit këto variabla janë:(MVR40m, MKGJVT, MHMED, MKLART, MUVRA, MSPRE dhe Mvz6m9m ). Duke analizuar rezultatet e paraqitura në këtë tabelë shihet se nga të gjitha variablat motorike dallimet ndërmjet nxënësve në këtë grup janë paraqitur në dy teste të forcës eksplozive në testin e kërcimit së gjati nga vendi me rezultatet minimale 130.00 cm maksimale 260.00cm mesatarja aritmetike 193.67cm ndërsa devijimi mjaft i lartë 26.127, poashtu edhe tek testi i hedhjes se medicinbollit tregon rezultatet të dallueshme mes nxënësve me rezultatet minimale 364.00cm, maksimale 620.00cm , mesatarja aritmetike 417.20cm dhe me devijm standard të lartë 48.646. Për të vërtetuar se ky grup sa i përket aftësive motorike nuk ka qenë heterogjen, tregojnë edhe vlerat asimetrike të skeë. dhe kurt. të cilat arrijn nga 2.224 deri në 6.600.

**Tabela 2 Parametrat themelor statistikor të variablave motorike bazike e situacionale në Deçan**

Variablat	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skeë.	Kurt.
MVR40m	70	5,47	8,18	6,51	,656	,674	-,110
MKGJVT	70	130,00	260,00	193,67	26,127	-,033	,431
MHMED	70	364,00	620,00	417,20	48,646	2,244	6,600
MKLART	70	12,10	45,20	28,93	7,118	,252	-,133
MUVRA	70	6,16	11,37	8,02	1,097	,403	,301
MSPRE	70	1,00	5,00	2,77	1,051	,015	-,850
Mvz6m9m	70	11,37	19,60	15,53	1,841	-,523	,178

#### **4.1.3. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave antropometrike në Podujevë.**

Parametrat themelor statistikore të katër variablave antropometrike për 70 nxënësit e komunës së Podujevës janë paraqitur në tabelën 3. Këto variola nga hapësira antropometrike mendohet se janë të mjaftueshme për këtë punim master. Duke analizuar rezultatet e fituara në tabelën e mëposhtme mund të vërehet se nga të gjitha variablat e hapësires antropometrike dallimet edhe tek këta nxënës janë paraqitur në peshë me rezultate asimetrike nga minimumi i cili është paraqitur me 43.10 kg dhe maksimumi me 103.80 kg ndërsa mesatarja aritmetike ka vlerën e 68.73 kg e cila ka një devijim të theksuar në vlerë prej 12.267. Me rezultatet e dalluara në peshë tek nxënësit nga komuna e Podujevës, rezultate tjera kanë qenë përafërsisht të njëjta dhe mund të themi se në hapësiren antropometrike grupi është homogjen dhe nuka kanë dallime njëri prej tjetrit.

**Tabela 3. Parametrat themelor statistikor të variablave antropometrike në Podujevë.**

Variablat	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skeë.	Kurt.
APESHA	70	43,10	103,80	68,73	12,267	,762	,901
ALART	70	157,00	193,00	176,54	6,643	-,025	,422
AGJKRH	70	156,00	191,00	175,17	6,885	,057	,118
AGJASH	70	17,00	22,00	18,84	1,009	,428	,249

#### **4.1.4. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave, motorike bazike dhe situacionale në Podujevë**

Rezultatet e parametrave themelore statistikore të hapësires motorike bazike dhe asaj situacionale tek nxënësit e komunës së Podujevës janë përzgjedhur të njëjtat variabla me ato të Komunës së Deçanit: (MVR40m, MKGJVT, MHMED, MKLART, MUVRA, MSPRE dhe Mvz6m9m). Duke analizuar rezultatet e paraqitura në tabelën 4 mund të vërejmë së rezultatet e testeve motorike nuk dallojnë shumë nga moshataret e tyre nga Komuna e Deçanit sepse edhe këtu dallimet ndërmjet nxënësve në këtë grup janë paraqitur në dy testet e forcës eksplozive në testin e kërcimit së gjati nga vendi me rezultatet minimale 120.00 cm maksimale 240.00cm mesatarja aritmetike 180.61cm ndërsa devijimi mjaft i lartë 23.403, poashtu edhe tek testi i hedhjes se medicinbollit tregon rezultatet të dallueshme mes nxënësve me rezultatet minimale 334.00cm, maksimale 576.00cm, mesatarja aritmetike 456.64cm dhe me devijim standard të lartë 54.344.

**Tab 4. Parametrat themelor statistikor të variablave motorike bazike e situacionale në Podujevë**

Variablat	N	Min	Max	Mean	Std. Dev.	Skeë.	Kurt.
MVR40m	70	5,75	9,17	7,02	,812	,283	-,385
MKGJVT	70	120,00	240,00	180,61	23,403	,128	,317
MHMED	70	334,00	576,00	456,64	54,344	-,242	-,544
MKLART	70	20,50	45,40	32,16	6,805	-,049	-1,236
MUVRA	70	6,25	10,52	8,26	,936	,274	-,461
MSPRE	70	0,00	5,00	2,68	1,257	,173	-,506
Mvz6m9m	70	11,51	18,21	14,49	1,867	,290	-1,029

## 4.2. Korelacionet ndërmjet rezultateve të nxënësve nga Deçani dhe Podujeva

Në këtë punim master janë analizuar edhe korelacionet ndërmjet hapësires antropometrike dhe motorikes bazike dhe asaj situacionale sikurse tek nxënësit nga Deçani dhe ata nga Podujeva. Janë llogaritur koeficientet e vlefshmërisë për shkallë të konkludimit të lartë statistikore në vlerë prej ( $p < 0.01$ ). ndërsa me shkallë më të lehtë të konkludimit statistikor ( $p < 0.05$ ).

### 4.2.1. Koeficientet e korelacioneve në hapësiren antropometrike Deçan

Rezultatet e koeficientëve të korelacioneve ndërmjet variablave antropometrike të nxënësve nga Deçani janë paraqitur në tabelën 5. Në amëzen e korelacionit të paraqitura mund të vërejm një korelacion mjaft të lartë ndërmjet variablave në hapësiren antropometrike me vlera të larta të cilat fillojnë nga 0.521\*\* e deri në 0.831\*\*. Duke analizuar rezultatet e fituara ato na japin një pasqyrë reale, për një korelacion të fortë ndërmjet këtyre variablave të faktorit longitudinal, ku vlerat e fituara janë mjaftë të larta, si dhe korelacioni ndërmjet variablave të faktorit longitudinal me atë të peshës janë paraqitur vlera të nivelit të lartë.

**Tabela 5. Koeficientët e korelacioneve të variablave antropometrike Deçan**

VARIABLA T	APESHA	ALART	AGJKRH	AGJASH
APESHA	1			
ALART	,533**	1		
AGJKRH	,521**	,831**	1	
AGJASH	,555**	,641**	,667**	1

#### 4.2.2 Koeficientët e korrelacioneve të variablave, motorike bazike dhe situacionale te Deçanit

Duke u bazuar në tabelën 6 ku janë paraqitur rezultatet e koeficientëve të korrelacioneve ndërmjet variablave të motorikes bazike dhe asaj situacionale të nxënësve nga Deçani. Në këtë amëz mund të vërejm korrelacion mjaft të lartë ndërmjet disa variablave në hapësirën motorike të cilat fillojnë nga 0.341\*\* e deri në 0.646\*\*. Duke bërë një analizë nga rezultatet e fituara ato na japin një pasqyrë reale, për një korrelacion të fortë ndërmjet këtyre variablave të faktorit të forcës eksplozive ndërmjet veti përveq testit të hedhjes së medicinbollit, ku vlerat e fituara janë të nivelit të lartë, si dhe korrelacioni ndërmjet variablave të faktorit të forcës eksplozive, testit të kërcimit së larti me ato të precizitetit janë paraqitur korrelacione të knaqshme.

**Tabela 6. Koeficientët e korrelacioneve të variablave motorike bazike dhe situacionale te Deçanit**

Variablat	MVR40m	MKGJVT	MHMED	MKLART	MUVRA	MSPRE	Mvz6m9m
MVR40m	1						
MKGJVT	-,646**	1					
MHMED	,158	,041	1				
MKLART	-,446**	,615**	-,023	1			
MUVRA	,563**	-,385**	,048	-,226	1		
MSPRE	-,407**	,385**	,155	,341**	-,239*	1	
Mvz6m9m	,424**	-,452**	-,033	-,544**	,196	-,235*	1

### 4.2.3 Koeficientet e korrelacioneve në hapësiren antropometrike në Podujevë

Në tabelën 7, janë paraqitur koeficientet e korrelacioneve ndërmjet variablave antropometrike të nxënësve nga Podujeva.

Rezultatet e koeficientëve të korrelacioneve ndërmjet variablave antropometrike të nxënësve nga Podujeva janë paraqitur në tabelën 7. Siç shihet në amëzen e korrelacionit të paraqitura mund të vërejm një korrelacion mjaft i lartë është paraqitur ndërmjet variablave në hapësiren antropometrike me vlera të larta të cilat fillojnë nga 0.431\*\* e deri në 0.953\*\*. Por duke analizuar rezultatet e fituara ato na japin një korrelacion jo të fortë ndërmjet variablës së gjatësisë së shuplakës me variablat e faktorit longitudinal, dhe të peshës ku vlera e saj korrelative është mjaft e ulët.

**Tabela 7. Koeficientët e korrelacioneve të variablave antropometrike në Podujevë**

	APESHA	ALART	AGJKRH	AGJASH
APESHA	1			
ALART	,467**	1		
AGJKRH	,431**	,953**	1	
AGJASH	,140	,471**	,544**	1



#### 4.2.4. Koeficientët e korrelacioneve të variablave, motorike bazike dhe situacionale në Podujevë

Në tabelën 8 janë paraqitur rezultatet e koeficientëve të korrelacioneve ndërmjet variablave të motorikes bazike dhe asaj situacionale të nxënësve nga Podujeva. Duke u bazuar në amëzen e paraqitur mund të vërehet se është dhënë korrelacion jo edhe aq i knaqshëm ndërmjet variablave në hapësirën motorike në krahasim me moshatarët e tyre nga Deçani. Duke analizuar rezultatet e fituara ato na japin një një korrelacion të fortë ndërmjet variablave të faktorit të forcës eksplozive ndërmjet veti kjo vërehet tek variablat e testit të shpejtësisë, ku vlerat e fituara janë të nivelit të lartë, si dhe korrelacioni ndërmjet variablave të njëjta me ato të precizitetit janë paraqitur korrelacione te larta vlera e të cilave sillet prej  $-.322^{**}$  deri  $.903^{**}$ .

**Tabela 8. Koeficientët e korrelacioneve të variablave motorike bazike dhe situacionale në Podujevë**

	MVR40m	MKGJVT	MHMED	MKLART	MUVRA	MSPRE	Mvz6m9m
MVR40m	1						
MKGJVT	,031	1					
MHMED	,099	,270*	1				
MKLART	-,199	,066	-,050	1			
MUVRA	<b>,903**</b>	-,058	,020	-,184	1		
MSPRE	<b>-,400**</b>	-,098	,099	,094	<b>-,420**</b>	1	
Mvz6m9m	<b>,752**</b>	-,082	,035	-,240*	<b>,821**</b>	<b>-,322**</b>	1

### 4.3. KROSKORELACIONET NË MES TË VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE

#### 4.3.1. Kroskorelacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike në hapësirën manifeste të nxënësve nga Deçani

Në tabelën nr. 9. është dhënë amëza e kroskorelacioneve ndërmjet variablave të hapësirës antropometrike dhe hapësirës motorike bazike dhe asaj situacionale të nxënësve nga Deçani. Rezultatet e paraqitur në tabelë janë vlerat e kroskorelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike e cila i ka katër variabla me variablat në hapësirën motorike dhe situacionale të cilat kanë së bashku shtatë variabla. Duke e analizuar amëzën e kroskorelacioneve ndërmjet dy hapësirave, mund të vërejmë se vlerat e fituara janë të një niveli të ulët dhe të mesëm të probabilitetit, të cilat janë dalluar në bazë të shkallës së ndërlidhjes. Vlenë të theksohet se rezultate të larta, nga hapësira motorike e që ka treguar kroskorelacion të lartë me të gjitha variablat antropometrike është testi i hedhjes së medicinbollit me APESHA, ALART, AGJKRH dhe me AGJASH në vlera prej 0.426. e deri në .766\*\*.

**Tabela Nr:9 Amëza e kroskorelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike në Deçan**

Variablat	APESHA	ALART	AGJKRH	AGJASH
MVR40m	,280*	,016	,025	-,042
MKGJVT	-,130	,083	,108	,166
MHMED	,766**	,569**	,505**	,426**
MKLART	-,268*	-,056	-,012	,018
MUVRA	,114	,059	,108	,017
MSPRE	,043	,103	,003	,108
Mvz6m9m	,223	,061	,037	,044

### 4.3.2.Kroskorelacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike në hapësirën manifeste të nxënësve nga Podujeva

Amëza e kroskorelacioneve ndërmjet variablave të hapësirës antropometrike dhe hapësirës motorike bazike dhe asaj situacionale të nxënësve nga Podujeva është paraqitur në tabelën 10. Në tabelë janë paraqitur vlerat e kroskorelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike e cila i ka katër variabla me variablat në hapësirën motorike dhe situacionale të cilat kanë së bashku shtatë variabla. Duke e analizuar amëzën e kroskorelacioneve ndërmjet këtyre dy hapësirave, për dallim nga moshataret e tyre nga Deçani këtu mund të vërejmë se vlerat e fituara nuk janë të koncentruara nga vetëm testi i hedhjes së medicinbollit por nga hapësira antropometrike vlera të larta të propabilitetit, ka paraqitur variabla e peshë e cila ka treguar kroskorelacion të lartë me dy testet e forcës eksplozive testet MVR40m në vlerë  $.760^{**}$ , MUVRA në vlerë prej  $.720^{**}$  dhe Mvz6m9m në vlerë  $.529^{**}$  gjithashtu me testin e precizitetit MSPRE në vlerë  $-.459^{**}$ . Vlenë të theksohet se rezultate të larta, nga hapësira motorike vlera të larta të kroskorelacionit ka treguar me variablat antropometrike APESHA, ALART, dhe AGJKRH është testi i vrapimit 40 metra me në vlera prej  $0.387^{**}$ . e deri në  $.762^{**}$ .

**Tabela Nr:10 Amëza e kroskorelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike në Podujevë**

	APESHA	ALART	AGJKRH	AGJASH
MVR40m	$.762^{**}$	$.435^{**}$	$.387^{**}$	$.064$
MKGJVT	$-.023$	$.182$	$.166$	$.266^*$
MHMED	$.128$	$.225$	$.193$	$.181$
MKLART	$-.031$	$.026$	$.033$	$.129$
MUVRA	$.720^{**}$	$.310^{**}$	$.276^*$	$-.045$
MSPRE	$-.459^{**}$	$-.104$	$-.117$	$.056$
Mvz6m9m	$.529^{**}$	$.156$	$.135$	$-.136$

#### 4.4. T – Testi ndërmjet grupit të nxënësve nga Deçani dhe nxënësve nga Podujeva në hapësirën antropometrike dhe motorike

Për të vërtetuar se a ka ndryshime ndërmjet dy grupeve të pavarura e në këtë rast grupi i nxënësve nga Komuna e Deçanit dhe grupi i nxënësve nga Komuna e Podujevës është përdorur analiza e T- testit, për grupe të pavarura. Nëpërmjet kësaj analize mund të krahasojmë dallimet e mesatareve aritmetikore në mes të këtyre dy grupeve. Në tabelën 11 janë paraqitur vlerat e ndryshimit ndërmjet dy mesatareve aritmetike dhe vlera sinifikante e analizës së t –testit. Duke u bazuar në vlerat e paraqitura në tabelë mund të vërejmë se në hapësirën antropometrike nuk janë paraqitur dallime sinifikante ndërmjet nxënësve të Deçanit dhe atyre të Podujevës.

**Tabela 11 Dallimet ndërmjet grupit të nxënësve nga Deçani dhe Podujeva në hapësirën Antropometrike**

Vriablat	Komuna	N	Mean	Std. Deviation	Sig. (2-tailed)
APESHA	Deçani	70	67,78	13,663	,664
	Podujeva	70	68,73	12,267	
ALART	Deçani	70	177,24	6,146	,519
	Podujeva	70	176,54	6,643	
AGJKRH	Deçani	70	177,02	6,626	,108
	Podujeva	70	175,17	6,885	
AGJASH	Deçani	70	18,81	1,021	,867
	Podujeva	70	18,84	1,009	

Në tabelën 12 janë paraqitur vlerat e ndryshimit ndërmjet dy mesatareve aritmetike në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj situacionale ndërmjet grupit të nxënësve nga Deçani dhe grupit të nxënësve nga Podujeva me vlera sinjifikante e analizës së t –testit. Duke i analizuar rezultatet e paraqitura në tabelë mund të vërejmë se në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj situacionale janë paraqitur dallime sinjifikante ndërmjet nxënësve të Deçanit dhe atyre të Podujevës.

Dallimet në mes të nxënësve nga Deçani dhe ata nga Podujeva tek testet e motorikes bazike tregojnë se janë fituar dallime të rëndësishme statistikore në favor të grupit të nxënësve nga Deçani tek testet e **MVR40m** në nivel **p= 0.000** dhe në testin e **MKGJVT** në nivel **p= 0.002**, ndërsa në hedhjen e medicinbollit dhe testi i kërcimit së larti grupi i nxënësve nga Podujeva ishin më të mirë në nivel **p= 0.000 përkatësisht** në nivel **p= 0.007**. Gjithashtu, dallimet në mes nxënësve në variablat e motorikes situacionale kanë treguar se janë fituar dallime të rëndësishme statistikore në favor të grupit të nxënësve nga Podujeva tek testi i **Mvz6m9m** në nivel **p= 0.001**, duke u bazuar në rezultatet tregojnë grupi i nxënësve nga Podujeva kanë rezultate më të mira vetëm në variablën e motorikes situacionale.

**Tabela 12 Dallimet ndërmjet grupit të nxënësve nga Deçani dhe Podujeva në hapësirën motorike**

Variablat	Komuna	N	Mean	Std. Deviation	Sig. (2-tailed)
MVR40m	Deçani	70	6,51	,656	,000
	Podujeva	70	7,02	,812	
MKGJVT	Deçani	70	193,67	26,127	,002
	Podujeva	70	180,61	23,403	
MHMED	Deçani	70	417,20	48,646	,000
	Podujeva	70	456,64	54,344	
MKLART	Deçani	70	28,93	7,118	,007
	Podujeva	70	32,16	6,805	
MUVRA	Deçani	70	8,02	1,097	,158
	Podujeva	70	8,26	,936	
MSPRE	Deçani	70	2,77	1,051	,662
	Podujeva	70	2,68	1,257	
Mvz6m9m	Deçani	70	15,53	1,841	,001
	Podujeva	70	14,49	1,867	

## 5. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.

Në këtë punim janë paraqitur katër hipoteza të cilat janë bazuar në qëllimin dhe problemin e këtij hulumtimi ato janë verifikuar në këtë mënyrë:

Në hipotezën e parë është supozuar se do të paraqiten dallimet në rezultatet nxënësve në hapësirën antropometrike ndërmjet Deçanit dhe Podujevës, duke u bazuar në rezultatet e arritura në këtë hulumtim vërehet se nuk ka dallime sinjifikante ndërmjet grupit të nxënësve nga Deçani dhe atyre nga Podujeva në hapësirën antropometrike dhe se kjo hipoteze nuk është vërtetuar.

Hipoteza e dytë gjithashtu ka supozuar se do të paraqiten dallimet në rezultatet nxënësve në aftësitë e motorikes bazike ndërmjet Deçanit dhe Podujevës, kjo hipotezë është plotësuar pjesërisht dhe janë paraqitur dallime në disa variabla të hapësirës e motorike bazike dhe rezultatet kanë treguar se grupi i nxënësve nga Deçani kanë qenë më të suksesshëm në realizimin e këtyre testeve.

Pjesërisht është vërtetuar edhe hipoteza e tretë dhe vetëm me një variabël janë paraqitur dallimi në rezultatet nxënësve në aftësitë e motorikes situacionale për lojën e hendbollit ndërmjet grupit të nxënësve nga Deçani dhe atyre nga Podujevës, rezultatet tregojnë në favor të grupit të nxënësve nga Podujeva të cilët me sukses e kanë realizuar këtë test.

## 6.PËRFUNDIMI

Një ndër qëllimet në këtë punim si dhe problemi i hulumtimit ka qenë vlerësimi, njohja e hapësirës antropometrike të nxënësve meshkuj në dy komuna të ndryshme në Kosovë jo të njejtit regjion gjeografik. Gjithashtu nëpërmjet këtij hulumtimi kemi arritur të njohim strukturën manifeste si në hapësirën morfologjike poashtu edhe në atë motorike bazike dhe situacionale për lojën e hendbollit me anë të analizave të përdorura kemi arritur në një konkludim me vlera statistikore.

Duke u bazuar në qëllimin dhe problematikën e këtij punimi në mënyrë për ti vlerësuar parametrat morfologjik të nxënësve nga dy komuna të ndryshme ajo e Deçanit dhe Podujevës si dhe aftësitë e motorikes bazike dhe motorikes situacionale në lojën e hendbollit. Gjithashtu përpunimi i rezultateve dhe interpretimi i tyre ka një vlerë praktike të shtuar për vlerësimin e lojës së hendbollit në shkollat e mesme të larta (Klasa e X) dhe ne e kemi vërtetuar se cila nga këto komuna i kushtojnë rëndësi më të madhe aplikimit të lojës së hendbollit në procesin edukativo arsimorë. Shpresojmë që ky punim do të jetë në funksion të trajnerëve të Hendbollit për të dy komunat të cilët do të kenë mundësi që të bëjnë përzgjedhjen e talenteve për lojën e Hendbollit dhe ti furnizojnë klubet me lojtarë nga shkollat e mesme.

Mostra e nxënësve në këtë punim do të jetë 140 nxënës prej tyre: nga 70 djem nga dy Shkolla të ndryshme njëra në Deçan dhe tjetra në Podujevë. Rezultatet e fituara të këtij punimi janë trajtuar nëpërmjet analizës deskriptive, Korrelacioneve dhe Kroskorrelacioneve dhe për të vërtetuar dallimin kemi përdorur.

Nëpërmjet analizës së T-testit për mostra të pavarura janë paraqitur dallimet në testet e motorikes bazike në favor të grupit të nxënësve nga Deçani tek testet e **MVR40m** në nivel **p= 0.000** dhe në testin e **MKGJVT** në nivel **p= 0.002**, ndërsa në hedhjen e medicinbollit dhe testi i kërcimit së larti grupi i nxënësve nga Podujeva ishin më të mirë në nivel **p= 0.000 përkatësisht** në nivel **p= 0.007**. Dallimet në mes nxënësve në variablat e motorikes situacionale ishin tek testi i **Mvz6m9m** në nivel **p= 0.001**, në favor të nxënësve nga Podujeva.

Shpresojmë që ky punim do të mund të jetë në funksion të njohjes dhe zhvillimit të karakteristikave të nxënësve më lojën e hendbollit (Koca,A. 2009), njëherit me këtë punim do të ju ofrojmë informacione të sakta eksperteve të lojës së hendbollit për të dy komunat në fjalë dhe se ata së bashku me trajner të klubeve nga këto komuna do të mund të bëjnë përzgjedhjen e hendbollistëve (meshkuj) në mënyrë që të masivizojnë sportin e hendbollit në këto dy komuna. (Gjinolli,E. 1982)

Punime të tilla të mostrave të ndryshme për sportin e hendbollit pasqyrojnë zhvillimin e aktiviteteve sportive nëpër shkolla e sidomos sportin e hendbollit, se sa nxënësit kanë arritur të mësojnë gjatë procesit mësimorë dhe sa kanë arritur të zhvillojnë aftësitë e motorikes bazike dhe asaj situacionale.

Duke përfunduar mund të themi se me rezultatet e fituara nga ky punim kemi arritur për të realizuar qëllimin tonë kryesor, dhe i kemi vërtetuar dallimet ndërmjet nxënësve të Deçanit dhe atyre të Podujevës.







## 7. BIBLIOGRAFIA

1. Çitaku,F.(1981).Hulumtim në hapësirën motorike në segmente të forcës, të shpejtësisë dhe të precizitetit, i ka realizuar me 118-sportistë aktiv (hendbollistë,basketbollistë dhe volejbollistë) të Ligës së Kosovës dhe të asaj federative\*.Elan, Prishtinë.
2. Çitaku,F.(1992).Stërviçja sportive në hendboll,UP-FKF Prishtinë 1992.
3. Çitaku,F.(1984).Relacionet e ca dimensioneve motorike në grup sportistësh të 3 dimensioneve sportive. Elan Nr:11 Prishtinë 1984
4. Koca, A. (2009) Relacionet dhe ndryshimet në hapësirën antropometrike funksionale dhe aftësive lëvizore bazike e të lëvizjeve situacionale ndërmjet hendbollistëve (juniorë) të superligës dhe ligës së parë të kampionatit të Kosovës në hendboll. Disertacion doktorature, Fakulteti i Kulturës Fizike, Prishtinë, Kosovë.
5. Nixha,M. (1985), Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të niveleve të ndryshme të garave dhe analiza komparative me hendbollistë dhe volejbollistë.
6. Rexhepi, A. (2009). Mjekësia Sportive. Ministria e Shëndetësisë. Qendra e Mjekësisë Sportive dhe Rekreacionit. Kolegji EUS Eurosporti, Prishtinë, Kosovë.
7. Rakovica,H.(1997). “ Relacionet në mes të rezultatit kërcim së larti dhe dimensioneve morfologjike dhe motorike”. Disertacion doktorature,Prishtinë.



8. Selimi, M. (2001). Punim Magjistrature Fakulteti i Kulturës Fizike, Prishtinë, Kosovë.
9. Gjinolli.,E. (1982). Ndikimi i programeve të ndryshme të procesit mësimorë të ed.fizike në disa dimensione të statusit psiko-somatik të nxënësve të klasave të pesta të shkollave fillore, elan nr.10.1982 dhe nr.11.1984 Prishtinë.
10. Zeqa.,V. (2004). Struktura frontale dhe racionet ndërmjet disa dimensioneve antropometrike dhe aftësive të hendbollit ,punim magjistrature, Prishtinë 2004.
11. Peqiq A: Interkorelacia i kroskorelacia motorskih funksionalnih karakteristika I motorickih sposobnosti,kineziologija 1-2 Zagreb 1981
12. Hasangjekaj.,B (1988), Metodika e Edukatës Fizike, Prishtinë 1998
13. Betez.,B. (1968), Elementarna Statistika , Zagreb 1968
14. Rushiti,H.(1999). Ndikimi i aktiviteteve kineziologjike në zhvillimin e disa karakteristikave psikosomatike te nxënësit "Acta kineziologika" Prishtinë.
15. Aliu, M, (1997). Biomotorika , Tekst universitar. Universiteti i Prishtinës FKF, Prishtinë.
16. Aliu,M .(1991), Zhvillimi i disa karakteristikave morfologjike dhe motorike të popullatës shkollore dhe ndryshimet në ato karakteristika në varshmëri me moshën kronologjike“, Disertacion doktore, Sarajevë.
17. Myrtaj, N. (2007) Ndikimi i aktiviteteve kineziologjike në transformimin e aftësive lëvizore motorike te të rinjët e moshës


## 8. PARAQITJA GRAFIKE E REZULTATEVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE NDËRMJET GRUPIT TË NXËNËSVE NGA DEÇANI DHE PODUJEVA











## PARAQITJA GRAFIKE E VARIABLAVE SITUACIONALE SITUACIONALE

